



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry  
of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**Inventarizimi i pasurisë së MASHT-it**

**NUMËR: 16/ 2010**  
**DATË: 15.10.2010**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 43.3,c të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1.**  
**Qëllimi**

**1.** Ky Udhëzim administrativ i mundëson MASHT-it:

- 1.1.** Sigurimin e menaxhimit efektiv të pasurive të MASHT-it;
- 1.2.** Mbajtjen e saktë të dhënave mbi pasuritë e MASHT.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Me këtë Udhëzim administrativ rregullohen procedurat e inventarizimit të pasurisë për përdorim nga MASHT.

**Neni 3**  
**Themelimi i komisionit**

Zyrtari kryesor administrative i MASHT-it duhet të themelojë Komisionin për inventarizimin e pasurisë në përputhje me nenin 4 të këtij udhëzimi.

**Neni 4**  
**Komisioni për inventarizimin e pasurive**

1. Komisioni për inventarizimin e pasurive do të jetë organ i formuar aty për aty nga MASHT si organizatë buxhetore.
2. Komisionin për inventarizimin e pasurive e cakton zyrtari kryesor administrativ.
3. Komisioni do të jetë si vijon:
  - 3.1. Të ketë jo më pak se tre anëtarë;
  - 3.2. Të përbëhet nga anëtarët që punojnë në MASHT.
4. Përgjegjësitë e komisionit për inventarizimin e pasurive janë si në vijim:
  - 4.1. Inventarizimi i gjithë pasurisë që e kontrollon MASHT-i;
  - 4.2. Identifikimi i pasurive që nuk kanë vlerë të bartur;
  - 4.3. Identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit;
  - 4.4. Duhet të përgatit raporte për kryerjen e inventarizimit.
5. Komisioni për inventarizim duhet të hartojë raporte të komisioneve Individuale dhe raportin e përgjithshëm për kryerjen e inventarizimit.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

  
**Enver Hoxhaj, ministër**

